 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Politika në lidhje me ndryshimet e kriterëve për akreditim, zgjerimit të veprimtarisë së DPA dhe fushës fleksibël</p>	<p>Kodi DA-PO-004</p>
		<p>Rishikimi nr 5 Dt: 08.06.2022</p>
		<p>Faqe 1 nga 4</p>

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithëshme të Akreditimit (DPA) në lidhje me ndryshimet në kriteret për akreditim dhe ndryshimeve të skemave të vlerësimit të konformitetit. Gjithashtu përshkruan edhe politikën e DPA për zgjerimin e veprimtarisë së saj në drejtim të ofrimit të shërbimit të akreditimit të gjithë palëve të interesuara.

2. Referimet

Ligji nr. 116/2014 „Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

S SH ISO/IEC 17011:2017, “Vlerësimi i konformitetit- Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit”, paragrafët 4.6, 7.8.4 dhe 8.2.3


EA 1/06 A AB:2022 Multilateral Agreement. Criteria for signing. Policy and procedures for development

Me termin “Skemë e akreditimit” kuptohen rregullat dhe proceset në lidhje me akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit tek të cilat aplikohet të njëjtat kërkesa.

Me termin “Kriterët për akreditim” nënkupton kërkesat e standardeve që aplikohen tek e njëjti organ i vlerësimit të konformitetit, dokumentat e lëshuara nga EA, ILAC dhe IAF dhe dokumentat e DPA.

3. Politika mbi ndryshimet në kriteret e akreditimit

Në përputhje me përkufizimin e akreditimit të dhënë në nenin 3 të ligjit nr. 116/2014 „Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë,, akreditimi bazohet në standardet e harmonizuara dhe sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit. Kriteret për akreditim janë dhënë në politikën DA-PO-002. Kur është e nevojshme ndryshimi i kriterëve të akreditimit, përpara miratimit të ndryshimit dhe datës efektive të zbatimit të ndryshimit, DPA do të marrë parasysh opinionin e palëve të interesuara. Kriteret për akreditim do të hartohen nga persona apo grupet teknike të punës përkatëse të cilët sigurojnë kompetencën teknike për hartimin e kriterëve/procedurave/rregullat dhe proceset si dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Politika në lidhje me ndryshimet e kriterëve për akreditim, zgjerimit të veprimtarisë së DPA dhe fushës fleksibël</p>	<p>Kodi DA-PO-004</p>
		<p>Rishikimi nr 5 Dt: 08.06.2022</p>
		<p>Faqe 2 nga 4</p>

Në rastet e ndryshimeve të standardeve të harmonizuara (niveli i tretë, niveli i katërt dhe/ose të dokumentave të tjera që përmbajnë kërkesa specifike përveç atyre të dhëna në standardet e nivelit të tretë, <https://european-accreditation.org/wp-content/uploads/2018/10/ea-1-06-A-AB.pdf>), DPA do të zbatojë vendimet e marra nga organizmat europianë dhe ndërkombëtar të akreditimit, në lidhje me periudhën e tranzicionit dhe mënyrën e zbatimit të tyre. DPA do të formulojë udhëzuesin e saj për mënyrën e implementimit të vendimeve të EA, ILAC dhe IAF me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.


Në rast të ndryshimeve në standardet/metodat e testimit/kalibrimit, procedurat e inspektimit apo certifikimit (niveli i pestë i standardeve), është grupi teknik përkatës i cili do të përcaktojë periudhën dhe mënyrën e tranzicionit, nëse është e nevojshme. Nëse ndryshimet janë sinjifikative, fusha e akreditimit të OVK do të ndryshojë vetëm pas një vlerësimi. Nëse ndryshimet nuk janë sinjifikative, OVK mund të përdorë versionin e fundit të standardit/metodës/procedurës dhe ndryshimi në fushën e akreditimit do të pasqyrohet në mbikëqyrjen e rradhës. Vlerësimi i rëndësisë (sinjifikasitetit) së ndryshimit përcaktohet nga grupi teknik i punës përkatës.

Në rast se ndryshimet në metoda/procedura janë bërë nga vetë OVK, ajo duhet të njoftojë menjëherë DPA sipas kontratës me DPA së bashku me një analizë si ndikon ndryshimi në plotësimin e kërkesave të akreditimit. Vendimi në lidhje me zbatimin e metodës/procedurës së ndryshuar do të merret nga grupi teknik i punës ose nga vlerësuesi teknik përkatës bazuar në vlerësimin e rëndësisë së ndryshimit.

DPA do të pasqyrojë ndryshimet në dokumentacionin e saj të brendshëm brenda periudhës tranzitore të caktuar nga organizmat europian/ ndërkombëtar ose nga grupi teknik i punës. Ajo do të trajtojë stafin e DPA dhe vlerësuesit në lidhje me ndryshimet dhe reflektimet e ndryshimeve në dokumentacionin e saj. Trajnimi do të organizohet brenda periudhës tranzitore.

DPA do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'ju informuar sa më shpejt që është e mundur për ndryshimet e standardeve apo kërkesave të vecanta të tyre. Gjithashtu ajo do të jetë e ndërgjegjshme për çdo ndryshim në udhëzuesit apo dokumentat e tjera të lëshuara nga EA, ILAC dhe IAF. Ajo do të zbatojë të gjitha rekomandimet e organizmave të sipërpërmendura.

DPA do të informojë të gjithë palët e interesuara si p.sh: stafin e DPA, vlerësuesit, anëtarët e bordit akreditimit, anëtarët e grupeve teknike, organizmat e akredituar, aplikuesit, institucionet dhe entet rregullatore, etj për çdo ndryshim në aktet ligjore, në standarde, udhëzues apo dokumenta të tjerë. Ky informacion do t'i shpërndahet jo vetëm

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Politika në lidhje me ndryshimet e kriterëve për akreditim, zgjerimit të veprimtarisë së DPA dhe fushës fleksibël	Kodi DA-PO-004
		Rishikimi nr 5 Dt: 08.06.2022
		Faqe 3 nga 4

më shkrim por ndryshimet do të pasqyrohen edhe në faqen e internetit të DPA sa më thjeshtë që të jetë e mundur. Gjithashtu DPA do të organizojë workshope për të informuar palët e interesuara si dhe për të sqaruar çdo paqartësi.

Në periudhën e tranzicioni, me kërkesë të OVK, vlerësimi mund të kryhet sipas versionit të ri ose paraardhësit të dokumentit, duke përfshirë kriteret për akreditim, sic rregullohet në dokumentat përkatës DA-IN. Vendimi mbi akreditimin/mbikëqyrjen do të bazohet tek vlerësimi. Tranzicioni tek versioni i ri ose dokumenti i ri duke përfshirë edhe kriteret për akreditim do të bëhet nëpërmjet mbikëqyrjeve të suksesshme.

4. Politika mbi zgjerimin e aktivitetit të akreditimit

DPA ka si objektiv të punës së saj ofrimin e shërbimit të akreditimit dhe plotësimin e kërkesave të klientëve. Ajo do t'i përgjigjet me korrektësi, kompetencë, pavarësi dhe paanëshmëri cdo kërkesë të klientit që mund të kërkojë zgjerim të skemave të akreditimit apo zgjerim të skemave të vlerësimit të konformitetit të cilat DPA nuk i ka praktikuar më parë. Në të dyja këto raste DPA do të bëjë përpjektjet maksimale për sigurimin e mundësive dhe burimeve për ofrimin e shërbimit, për gjetjen e burimeve të nevojshme për ekspertiza si psh në grupet teknike, për hartimin e dokumentacionit, rregullave dhe proceseve të nevojshëm si dhe për trajnimin e vlerësuesve në lidhje me skemat e reja të akreditimit ose të vlerësimit të konformitetit. Detajet në lidhje me zgjerimin e aktivitetit janë dhënë në procedurën DA-PM-008.

DPA do të informojë të gjitha palët e interesuara në lidhje me zgjerimin e aktivitetit të saj si dhe ndryshimet do të pasqyrohen edhe në faqen e DPA në internet. DPA do të informojë organin e vlerësimit të konformitetit nëse procesi i zgjerimit të aktivitetit do të zgjasë apo nëse vendimi është që DPA nuk do të zgjerojë aktivitetin e saj.

DPA nuk do të vazhdojë të ofrojë një skemë akreditimi pjesërisht ose të tërën nëse kërkohet palët e interesuara ose është përcaktuar nga organizmat europiane ose ndërkombëtare të akreditimit. Përpara vendimit të mosofrimit të një skeme, DPA do të plotësojë të gjitha detyrat kontraktuale të saj dhe periudhat e tranzicionit. DPA do të informojë të gjitha palët e interesuara si dhe do të publikojë në ëbsitin e saj arsyet e mosofrimit të një skeme akreditimi.

5.Politika mbi fushën fleksibël

Për momentin DPA nuk ofron akreditim për fushë fleksibël.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

**Politika në lidhje me ndryshimet e kriterëve për
akreditim, zgjerimit të veprimtarisë së DPA dhe
fushës fleksibël**

Kodi DA-PO-004

**Rishikimi nr 5
Dt: 08.06.2022**

Faqe 4 nga 4

Data: 08.06.2022

Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI